



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/38

Datë: 15.07.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 15 korrik 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkriptet nga mbledhjet 29 dhe 30 të Qeverisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/38

Datë: 15.07.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 15 korrik 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Agjencionit për Financimin Shëndetësor.
2. Obligohet Agjencioni për Financimin Shëndetësor dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/38

Datë: 15.07.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke u bazuar në Strategjinë për Rregullimin më të Mirë 2014-2020, shtojca 2 e Planit të Veprimit, Reformat e Legjislacionit ekzistues për të rritur konkurrueshmërinë, në mbledhjen e mbajtur më 15 korrik 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Udhërrëfyesi për Vlerësimin Ex-post të Legjislacionit në Republikën e Kosovës, i cili është bashkëngjitur këtij Vendimi.
2. Ministrinë-organet proponente janë përgjegjëse për kryerjen e analizës së vlerësimit Ex-post siç përcaktohet në Udhërrëfyes.
3. Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit themelon Grupin mbikëqyrës me përfaqësues të departamenteve ligjore të ministrive të linjës që koordinon vlerësimin Ex-post për ligjet e të gjitha ministrive. Grupi Mbikëqyrës udhëhiqet nga përfaqësuesi i Zyrës Ligjore të Zyrës së Kryeministrit.
4. Në gjashtëmujorin e parë pas hyrjes në fuqi të këtij Udhërrëfyesi, Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit në bashkëpunim me ministrinë, identifikon deri në dy ligje për vlerësim në bazë të udhërrëfyesit, si pilot projekt.
5. Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit në bashkëpunim të ngushtë me Grupin mbikëqyrës, është përgjegjëse për koordinimin e punëve ndërminstrore dhe krijon Programin Vjetor Vlerësues Ex-post.
6. Ministrinë përkatëse, mund të themelojnë grupe të punës për realizimin e vlerësimit Ex-post të legjislacionit në Kosovë, nga fushëveprimi i tyre. Grupet Punuese miratohen nga Sekretaret e Përgjithshëm të Ministrive, në koordinim me Grupin Mbikëqyrës dhe në pajtim me Programin Vjetor Vlerësues Ex-post.
7. Obligohen të gjitha departamentet/njësitë përkatëse të ofrojnë mbështetje organit proponent në procesin e vlerësimit Ex-post siç kërkohet në Udhërrëfyes.

8. Varësisht së çfarë përcakton Raporti i Vlerësimit Ex-post për secilin ligj të vlerësuar, ministritë-organet propozuese do të sigurojnë që rezultatet e vlerësimit Ex-post reflektohen në programet e ardhshme legjislative dhe do të siguroj që draft legjislacioni i ri pasqyron përfundimet dhe rekomandimet e Raportit të Vlerësimit Ex-post.
9. Pas hyrjes në fuqi të këtij Udhërrëfyeti, Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit promovon dhe siguron mbajtjen e trajnimeve për zyrtarët e departamenteve ligjore dhe departamenteve të fushës përkatëse lidhur me përdorimin e vlerësimit Ex-post në bashkëpunim me Institutin Kosovar për Administratë Publike, ministritë e linjës dhe donatorët e ndryshëm.
10. Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit është përgjegjëse për rishikimin e këtij udhëzuesi bazuar në praktikën më të mira dhe reagimeve të marra nga përvojat në vlerësimet Ex-post.
11. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/38

Datë: 15.07.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 15 korrik 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për fushën e Statistikave Zyrtare në Republikën e Kosovës.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/38

Datë: 15.07.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 15 korrik 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim nisma për lidhjen e Marrëveshjes bilaterale për zbatimin e programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar që financohet në kuadër të Instrumentit të Para-Anëtarësimit (IPA) 2014-2020 në mes Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Malit të Zi.
2. Obligohet Ministria e Integritimit Evropian të ndërmarrë të gjitha hapat në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim të finalizimit të tekstit përfundimtar të marrëveshjes.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/38

Datë: 15.07.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 15 korrik 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet nisma e Ministrisë së Financave për negocimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare për Bashkëpunim Zhvillimor (marrëveshjen kornizë) me Qeverinë Federale të Republikës së Gjermanisë.
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, obligohet Ministria e Financave të procedoj konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/38

Datë: 15.07.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores nr. 06/2010 për procedurat e emërimit në pozita të larta drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 15 korrik 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Z. Beqir Mezelxhiu emërohet Kryeshef Ekzekutiv i Agjencisë së Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguria Bërthamore.
2. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi zgjat tre (3) vjet.
3. I emëruari nga pika 1. e këtij vendimi kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
4. Obligohet Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyj në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/38

Datë: 15.07.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 15 korrik 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Qeverisë nr. 07/30 i datës 20.05.2015.
2. Pika 2. e vendimit zëvendësohet me tekstin si në vijim: "Koordinatorit Politik për Bisedime në mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë z. Blerim Shala, i emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me 16 prill 2015 i ndahet një Zyrë, gjithashtu për punën e tij do ta ndihmoj dhe mbështes një asistent, një shofer, stafi i Ministres pa Portofol dhe Zyra e Kryeministrit". Paga e asistentit dhe shoferit do të sigurohen nga buxheti i pagave - Zyra e Kryeministrit.
3. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë